



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

P.nr.02/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vet vetëm gjykues Ramiz Azizi, në lëndën penale kundër të pandehurit A. K., nga fshati komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 314 paragrafi 6 dhe 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor-vërejtje gjyqësore të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.244/2022, të datës 10.02.2022, më datën 27.04.2022, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

A. (R.) K., i lindur më 01.05.1969, në Fshatin ... k.e Novobërdës ku edhe jeton, me numër personal, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës,

Është fajtor

Për shkak me datë 04 dhjetor 2021, në fshatin ..., komuna e Novobërdës, pas vërtetimit të gjendjes faktike të njësorit elektrik nga puntorët e KEDS-it, është konstatuar se i pandehuri A. K. si shfrytzues i energjisë elektrike, me qëllim që vetes ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë vjedhjen e energjisë elektrike, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, dhe në këtë mënyrë ka bërë hargjimin e paautorizuar të energjisë elektrike, me qka ka pamundësuar regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, duke e dëmtuar të dëmtuarën KEDs-in Distrikti në Gjilan, në vlerë prej 105.36 Euro.

- me qka e ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par.6 e 1 të KPRK-së, rë përshkruara

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,81 e 82 të KPRK, si dhe nenit 493 dhe 498 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

E dëmtuara KEDS-i nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit A. K. nga fshatri komuna e Novobërdës, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 314 paragrafi 6 e 1 i KPRK. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet vërejtja gjyqësore, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjyqtari, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit A. K. dhe të pandehurit i shqiptoi vërejtjen gjyqësore, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të kallzimit penal 17 të dëmtuarës, procesverbaleve të bëra në vendngjarje si dhe shkresave të tjera që gjenden në shkresa të lëndës, gjyqtari konstatoi se i pandehuri A. K., nga nga fshati ... komuna e Novobërdës, ka kryer veprën penale pranimi vjedhja e shërbimeve komunale, nga neni 314 paragrafi 6 e 1 i KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lart, gjykata e ka pranuar kërkesën e PSH dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar vërejtjen e propozuar gjyqësore, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, kjo vërejtje është e drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me shqyrtimin e të njejtës, do të mund të arrihet qëllimi i Vërejtjes, nga neni 81 të KPRK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP, kurse, vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenit 463 paragrafi 2 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 e 498 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NOVOBERDE

Më 27.04.2022

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi**

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.*